



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
 AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. DPKI	18/10/25
Br. Str. 06	09.09.2025

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti EIEYKI-0142/25, me pretendimet për konflikt interesi të zyrtarëve publik në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të interesit për zyrtarët Fadil Veseli, Valon Veseli dhe Sefer Veseli, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe Rregulloren për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimi të një raportimi me shkrim (EIEYKI-0142/25), me pretendimin për konflikt të interesit *"lidhur me punësime familjare nga Valon Veseli dhe Fadil Veseli të cilët kana punësuar H.V., e cila është vajza/motra e tyre."* Tutje, raportuesit pretendon se: *"në rastin në fjalë konkursi hapet vetëm formalisht dhe se personat përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit nuk marrin pjesë në proces dhe nënshkrimet e të njëjtëve falsifikohen."* Në ndërkohë Agjencia ka pranuar raportimin tjetër (GYHOBZ-0150/25), me pretendimin se: *"Fadil Veseli ka punësuar vajzën e tij V.M. (e martuar në Kushtovë), si arkatare në ambulanten e fshatit Çabër, ku Valon Veseli e hapë konkursin formalisht në emër të drejtorit Hysen Mehmeti, pastaj i falsifikon nënshkrimet e komisionit formal dhe e punëson motrën e tij."* Gjithashtu, raportuesi pretendon se: *"të njëjtit (Fadil dhe Valon Veseli), punësojnë Vajzën e axhës së tyre H.V. si punëtore teknike në ambulanten e fshatit Çabër."* Pastaj, raportuesi pretendon se: *"Sefer Veseli, nënkryetar i komunës së Zubin Potokut ka punësuar bashkëshorten e djalit N.N. si infermiere në të njëjtën ambulante."* Gjithashtu, për rastin e njëjtë Agjencia ka pranuar edhe një denoncim tjetër nga raportuesi anonim

(OIQYAB-0149), me pretendimin se: “*Fadil Veseli dhe Valon Veseli punësojnë si arkatare në fshatin Çabër vajzën, përkatësisht motrën V.V., dhe se në të njëjtën ambulante të gjithë të punësuarit janë familjarë (duke ju referuar mbiemrit Veseli) dhe janë në konflikt të interesit.*”

Bazuar në raportimet e sipërpërmendura, përveç pretendimeve lidhur me konfliktin e interesit, janë paraqitur edhe pretendime tjera, përfshirë ato: se konkursi hapet vetëm në mënyrë formale; se personat përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit nuk marrin pjesë realisht në proces; si dhe se nënshkrimet e tyre janë falsifikuar. Pretendimet e tilla tejkalojnë mandatin ligjor të Agjencisë, dhe si rrjedhojë nuk janë trajtuar në këtë procedurë.

Konform nenit 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ka njoftuar palët për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit (*shkresat zyrtare: DPKI-06-1647/25; DPKI-06-1648/25*).

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në ambientet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit janë realizuar takime me palët e përfshira, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë, ndërsa të njëjtit kanë paraqitur sqarimet e tyre lidhur me pretendimet e ngritura për dyshime të vendimmarrjes në situatë të konfliktit të interesit me rastin e ushtrimit të funksionit publik.

Gjithashtu, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar dhe mbledhur informata të tjera relevante nga institucionet përkatëse lidhur me pretendimet e raportuesve, respektivisht Agjencia gjatë trajtimit të rastit ka shqyrtuar shkresat e lëndës të siguruara Komuna e Zubin Potokut (DPKI-1448/25); shkresën DPKI-1618/25, nga Valon Veseli; shkresën DPKI-1695/25, nga Komuna e Zubin Potokut; shkresën DPKI-1708/25, nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë; shkresën DPKI-1741/25, nga Sefer Veseli, si dhe shkresën DPKI-1747/25, nga të cilat rrjedhë se:

Lidhur me pretendimin e parë (EIEYKI-0142/25), për konflikt të interesit “... *për punësimin familjare nga Valon Veseli dhe Fadil Veseli të cilët kana punësuar H.V., e cila është vajza/motra e tyre...*,” sipas shkresave të lëndës Agjencia ka gjetur se:

Përmes shkresës nr.111, të datës 07.03.2025, znj. Gordana Mihajlovic, Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Zubin Potokut, ka paraqitur kërkesë për shpallje të konkursit për gjithsej tri (3) pozita, ndër to edhe një (1) pozitë për *Asistent/e për arkë*, kërkesë e cila është aprovuar përmes Vendimit nr.118 i datës 07.03.2025, të Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut z. Izmir Zeqiri. Në mungesë të kapaciteteve të brendshme njerëzore, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, përmes korrespondencës elektronike, i është drejtuar kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, me kërkesën për dërgimin e pesë (5) anëtarëve për formimin Komisionit të Pranimit. Pas pranimi të propozimeve për anëtarë nga Komuna e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, përmes Vendimit nr.261 i datës 15.04.2025, ka formuar Komisionin e Pranimit për pozitën në fjalë.

Në vijim të procedurës së rekrutimit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (tutje: NJMBNJ) e Komunës së Zubin Potokut, më datë 07.04.2025 përmes Njoftimit nr.188 ka shpallur listën e kandidatëve për verifikim paraprak, i cili njoftim ishte pasuar me Njoftimin nr.291, i datës 30.04.2025 të NJMBNJ, për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim për pozitën

Asistente për arkë. Sipas të dhënave të Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (tutje: SIMBNJ), me datën 06.05.2025, anëtarët e Komisionit të Pranimi kanë nënshkruar listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve, e cila është pasuar me konfirmimin e përfundimit të konkurrimit nga NJMBNJ, përmes SIMBNJ, i datës 09.06.2025.

Pas përfundimit të procesit të rekrutimit lidhur me këtë konkurs, NJMBNJ e Komunës së Zubin Potokut, përmes shkresës nr.01/304 të datës 06.05.2025, ka njoftuar për rezultatet përfundimtare të vlerësimit, sipas të cilave kandidatja V.M. është shpallur fituese, e për të cilën më datën 09.06.2025, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut ka nënshkruar Akt emërimit për themelimin e marrëdhënies së punës.

Lidhur me këtë rast, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut z. Zeqiri, përmes shkresës zyrtare DPKI-1448/25, ka sqaruar se: *“Në mungesë të kapaciteteve të veta komuna e Zubin Potokut për formimin e komisionit sipas nenin 40, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publik, ka kërkuar ndihmë nga Komuna e Vushtrrisë dërgimin e pesë (5) anëtarëve për pozita të kategorisë profesionale. [...] dhe se lidhur me këtë proces nuk ka pas ankesë në KPMSHCK.”*

Për të verifikuar ndonjë njoftim apo raportim të anëtarëve të Komisionit të Pranimi, për tentim apo ushtrim të ndikimit në vullnetin e tyre (neni 16 i LPKI-së) me rastin e vendimmarrjes në këtë proces të rekrutimit, Agjencia ka kërkuar informata nga ZKA e Komunës së Vushtrrisë, i cili përmes shkresës zyrtare DPKI-1708/25 ka deklaruar se: *“Unë si kryetar i Komunës nuk kam pasur asnjë njoftim verbal apo me shkrim se ndaj anëtarëve të Komisionit të rekrutimit në procedurën me Nr. të referencës RN00017006, ka pasur ushtrim ndikimi sipas nenit 16, të Ligjit Nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.”*

Gjithashtu, lidhur me rastin në fjalë përmes shkresës DPKI-1618/25, Agjencia ka pranuar sqarim edhe nga Valon Veseli, i cili ka deklaruar se në asnjë formë nuk ka qenë pjesë e asnjë procedure të rekrutimit për të cilat janë ngritur pretendime për konflikt të interesit.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar edhe raportimin tjetër (GYHOBZ-0150/25), me pretendimin e njëjtë si në rastin e parë, por të plotësuar dhe zgjeruar me elemente të reja dhe persona të tjerë. Respektivisht, raportuesi pretendon se: *“Fadil Veseli ka punësuar vajzën e tij V.M. (e martuar në Kushtovë), si arkatare në ambulanten e fshatit Çabër, ku Valon Veseli e hapë konkursin formalisht në emër të drejtorit Hysen Mehmeti, pastaj i falsifikon nënshkrimet e komisionit formal dhe e punëson motrën e tij.”* Gjithashtu, raportuesi pretendon se: *“të njëjtit (Fadil dhe Valon Veseli), punësojnë Vajzën e axhës së tyre II.V. si punëtore teknike në ambulantën e fshatit Çabër.”* Pastaj, raportuesi pretendon se: *“Sefer Veseli, nënkryetar i komunës së Zubin Potokut ka punësuar bashkëshorten e djalit N.N. si infermiere në të njëjtën ambulantë.”*

Pretendimi i parë i raportuesit (GYHOBZ-0150/25), është i njëjtë me pretendimin e raportuesit me numër (EIEYKI-0142/25), i cili është sqaruar më lartë dhe si i tillë është czauruar, e për të cilën situatë Agjencia ka pranuar edhe një raportim me shenjë OIQYAB-0149.

Lidhur me pretendimin e dytë të raportuesit (GYHOBZ-0150/25), se: *“të njëjtit (Fadil dhe Valon Veseli), punësojnë Vajzën e axhës së tyre II.V. si punëtore teknike në ambulantën e fshatit Çabër”*, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës zyrtare DPKI-973/25, ka

kërkuar dokumentacionin lidhur me procesin përkatës të rekrutimit nga Komuna e Zubin Potokut, ku pas pranimit (DPKI-1448/25), dhe analizimit të së njëjtit është gjetur se:

Përmes shkresës nr.323, të datës 08.05.2025, znj. Gordana Mihajlovic, Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi në Komunën e Zubin Potokut, ka paraqitur kërkesë për shpallje të konkursit për gjithsej dy (2) pozita, njëra nga to, një (1) pozitë për *Punëtor teknik*, kërkesë e cila është aprovuar përmes Vendimit nr.331 i datës 08.05.2025, të Kryetarit të Komunës së Zubin Potokut z. Izmir Zeqiri. Pastaj, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, përmes Vendimit nr.366 i datës 27.05.2025, ka formuar Komisionin e Pranimit për pozitën në fjalë me përbërjen K.Z., A.D., dhe B.D.

Në vijim të procedurës së rekrutimit, NJMBNJ e Komunës së Zubin Potokut, më datë 07.04.2025, përmes Njoftimit nr.363 ka shpallur listën e kandidatëve për verifikim paraprak me të vetmin kandidat II.V., i cili njoftim ishte pasuar me Njoftimin nr.374 të datës 29.05.2025, të anëtarëve të Komisionit të Pranimit, për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për pozitën *Punëtor teknik* (me vetëm një kandidat II.V.).

Lidhur me këtë rast, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut z. Zeqiri, përmes shkresës zyrtare DPKI-1448/25, ka sqaruar se, lidhur me këtë proces nuk është dorëzuar asnjë ankesë në arkivin e Komunës, dhe se *"Lista përfundimtare e kandidatëve fitues është bashkangjitur në formatin pdf me emrin RN00017813, ndërsa kandidatja ende nuk e ka nënshkruar kontratën me kohë të pacaktuar, sepse lista përfundimtare është publikuar me 29.05.2025, ku afati i fundit për ankesa është deri më datën 29.06.2025, edhe pse vetëm një candidate ka aplikuar për pozitën Punëtor Teknik"*.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të tretë të raportuesit (GYHOBZ-0150/25), se: *"Sefer Veseli, nënkryetar i komunës së Zubin Potokut ka punësuar bashkëshorten e djalit N.N. si infermiere në të njëjtën ambulante"*, me qëllim të verifikimit të pjesëmarrjes eventuale të palës së raportuar në këtë proces të rekrutimit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës zyrtare DPKI-973/25, ka kërkuar dokumentacionin lidhur me procesin përkatës të rekrutimit nga Komuna e Zubin Potokut, ku pas pranimit (DPKI-1448/25), dhe analizimit të së njëjtit është gjetur se:

Sipas shkresës nr.154, të datës 11.12.2023, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, kishte kërkuar nga NJMBNJ, zhvillimin e procedurave për pozitën *Infermiere/e*. Pastaj, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut, përmes Vendimit nr.162 i datës 18.12.2023, ka formuar Komisionin e Pranimit për pozitën në fjalë me përbërjen S.A. kryetar i komisionit, A.V. dhe H.M. anëtar.

Në vijim të procedurës së rekrutimit NJMBNJ, e Komunës së Zubin Potokut, më datë 19.01.2024, ka publikuar listën (NJMBNJ-98) e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit, i cili njoftim ishte pasuar me Njoftimin nr. NJMBNJ-99 të datës 22.01.2024, me rezultatet e arritura në testin me shkrim, si dhe Njoftimin nr. NJMBNJ-112 të datës 25.01.2024, me rezultatet e arritura në intervistë. Pastaj, me datën 25.01.2024, NJMBNJ, ka publikuar listën përfundimtare (NJMBNJ-113), dhe në të njëjtën datë anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, përmes Vendimit nr.117, si kandidat fitues në këtë proces kanë përzgjedhë kandidaten N.N., e cila edhe ka lidhur marrëdhënie të punës (Kontrata me nr. NJMBNJ-154 e datës 02.02.2024), me Komunën e Zubin Potokut, ku në cilësi të punëdhënësit kontrata në fjalë është nënshkruar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore.

Lidhur me këtë rast, Agjencia ka kërkuar sqarim nga Nënkrjetari Komunës së Zubin Potokut z. Sefer Veseli, i cili përmes shkresës DPKI-1741/25, mes tjerash ka deklaruar se: *“në kohën kur është punësuar N.N., nuk e kam njohur të njëjtën dhe nuk kam ndikuar në asnjë formë në punësimin e saj, dhe se pas punësimit është njoftuar me djalin tim dhe janë martuar”*, ku si dëshmi ka dërguar Certifikatën e Martesës së N.N. dhe XH.V., e cila mban datën 03.07.2025.

Lidhur me këtë rast, Kryetari i Komunës së Zubin Potokut z. Zeqiri, përmes shkresës zyrtare DPKI-1448/25, ka sqaruar se nuk është pranuar ndonjë ankesë në arkivin e Komunës.

Për të verifikuar ndonjë njoftim apo raportim të anëtarëve të Komisioneve të Pranimit (*Sipas Vendimit nr.01/366 dhe Vendimit nr.01/162*), për tentim apo ushtrim të ndikimit në vullnetin e tyre (*neni 16 i LPKI-së*) me rastin e vendimmarrjes në këto procese të rekrutimit, Agjencia ka kërkuar informata nga ZKA e Komunës së Zubin Potokut, i cili përmes shkresës zyrtare DPKI-1695/25 ka deklaruar se: *“[...] ju njoftoj se anëtarët e komisionit të pranimeve, sipas Vendimit Nr.01/366 të datës 27.05.2025 dhe Vendimit Nr.01/162 të datës 18.12.2023, nuk kanë paraqitur asnjë njoftim me shkrim për ndonjë tentim apo ushtrim të ndikimit mbi vullnetin e tyre.”*

Agjencia ka pranuar edhe një raportim me shenjë OIQYAB-0149, i cili përmban pretendime se: *“Fadil Veseli dhe Valon Feseli, hapin konkursin dhe punësojnë vajzën përkatësisht motrën V.M., e martuat në Kushtova, si arkatare në ambulanten e fshatit Çabër”*, duke shtuar se: *“në ambulante punojnë krejt familjar Veseli, janë konflikt interesi”*.

Pretendimi i parë sipas këtij raportimi është i njëjtë me pretendimet e raportuesit me numër EHEYKI-0142/25, dhe si i tillë është shqyrtuar më sipër. Ndërsa, sa i përket pretendimit të dytë, i njëjti është i natyrës së përgjithshme, pasi nuk specifikon ndonjë zyrtar konkret, proces të caktuar rekrutimi apo vendimmarrje nga e cila mund të rrjedhë konflikti i interesit. Për më tepër, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe deklaratave të personave të përfshirë në proces, nuk është konstatuar që personat e përmendur të jenë përfshirë proceduralisht në ndonjërin nga procedurat e rekrutimit që kanë qenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë.

Referuar sqarimeve të deritanishme, sipas shkresave të lëndës palët e raportuara për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nuk kanë marrë pjesë në vendimmarrje në asnjë fazë të proceseve përkatëse të rekrutimit që do të binte ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e as që është pranuar ndonjë raportim (te udhëheqësit e institucioneve) nga ana e komisioneve përkatëse të pranimit për tentim apo ushtrim të ndikimit në vullnetin e tyre.

Kjo për faktin se, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij*

dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalime Konflikti të Interesit, me të cilin është përkufizuar se: “interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”, dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: “person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin [...]”.

Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalime Konflikti të Interesit, e përkufizon nocionin vendimmarrje si: “çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”

Në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë, pjesëmarrja e zyrtarit në vendimmarrje dhe ekzistimi i interesit privat (çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste) të zyrtarit në atë vendimmarrje, janë kushte kumulative të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t’u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të Ligjit për Parandalime Konflikti të Interesit.

II. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur, ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit